



LETËRNJOFTIMI I KOMUNAVE

Skënderaj

2021

Letërnjoftimi i Komunave **Skënderaj**

Shtator 2021

— Përmbajtja

Fakte kryesore	4
Popullsia	4
Zgjedhjet	5
Diaspora	5
Territori	6
Përfaqësimi politik	7
Buxheti	8
Mirëqenia Sociale dhe Shëndetësia	12
Skema e ndihmës sociale	12
Shëndetësia	13
Arsimi	14
Administrata komunale	16
Transparenca	18
Transparenca buxhetore	18
Transparenca komunale	19
Konkurueshmëria e komunave	20
Ekonomia lokale	21
Shërbimet publike	23
Qasja në ujësjellës	23
Menaxhimi i mbeturinave	26

Përmbledhje


- Komuna e Skënderajt ka 52,372 banorë. Nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, Skënderajt ka pësuar **shtim natyror pozitiv prej 3%**.
- Nga 400,000 pjesëtarët e diasporës së regjistruar, **3.12% apo 12,480** persona kanë lindur në Komunën e Skënderajt.
- Komuna e Skënderajt ka territor prej **378km² apo 3%** të sipërfaqes së territorit të Kosovës.
- Komuna e Skënderajt përbëhet nga qyteza e Skënderajt si qendër urbane dhe **51 fshatra**.
- Skënderajti renditet si komuna e 21-të për nga densiteti i popullsisë (**138 banorë për kilometër katrorë**).
- Buxheti i planifikuar i Komunës së Skënderajt për vitin 2021 është rreth **14,2 milionë euro**.
- Të hyrat kryesore komunale për Komunën e Skënderajt janë tatimi në pronë dhe taksat e tjera komunale
- Pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Skënderajt shpenzohet për **paga dhe mëditje (57%)**.
- **21%** e buxhetit të Komunës së Skënderajt ndahet **për investime kapitale**.
- **8%** (922 familje me gjithsej 4,104 anëtarë) e banorëve të Skënderajt **janë në skemën e ndihmës sociale**.
- Në Skënderajt janë të angazhuar gjithsej **178 punëtorë shëndetësorë** (30 mjekë, 105 infermierë, tre stomatologë, një farmacist/e dhe 39 bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe jo medicinal).
- Në Komunën e Skënderajt mësimin e ndjekin **9,775 nxënës** në të gjitha nivelet e arsimit para univesitarë.
- Komuna e Skënderajt ka të punësuar **664 mësimdhënës, 129 pesona ndihmës dhe 66 administrativ**.
- Në Komunën e Skënderajt janë të punësuar **175 shërbyes civil**, apo një shërbyes civil për 299 banorë.
- **25%** e shërbyesve civil në Skënderajt **janë gra**.
- Në shërbimin civil komunal të Skënderajt, gratë udhëheqin **13%** të pozitave udhëheqëse.
- **Mosha mesatare** në shërbimin civil të Komunës së Skënderajt është **49 vjeç**.
- Në Komunën e Skënderajt janë aktive **1,431 biznese me 2,541 të punësuar**.
- Në territorin e Komunës së Skënderajt, **në sektorin publik janë të punësuar 1,300 persona**.
- Komuna e Skënderajt ka **7,265 kontributpagues aktiv** në Fondin e Kursimeve Pensionale (Trust).
- **80.38%** e sipërfaqes së komunës së Skënderajt ka qasje **në rrjet të ujësjellësit**.
- Komuna e Skënderajt është një ndër komunat me **shtrirje mesatare të rrjetit të kanalizimit**.
- Komuna e Skënderajt renditet e 26-ta për nga rrjeti i **menaxhimit të mbeturinave**.

Fakte kryesore

Popullsia


Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) del se më 31 dhjetor 2019 Komuna e Skënderajt kishte 52,372 banorë. Nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, Skënderaj ka pësuar shtim natyror pozitiv prej 3%.

Fig. 1 Popullsia e komunës së Skënderajt



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK dhe OSBE

Fig. 2 Trendet e popullsisë në komuna 2011-2019




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK 2011 dhe 2019

Zgjedhjet

Në zgjedhjet parlamentare që u mbajtën më 14 shkurt 2021 në listën e votuesve nga Komuna e Skënderajit ishin 51 mijë persona apo rreth 500 më shumë se numri total i popullsisë.

Fig. 3 Trendi i votuesve të regjistruar dhe dalja në zgjedhjet për kuvend komunal




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e KQZ, të dhënat për 2021 janë për zgjedhjet parlamentare

Diaspora

Sipas Rezultateve Preliminare të Regjistrimit të Diasporës¹, nga 400,000 pjesëtarët e diasporës së regjistruar, 3.12% apo 12,480 persona kanë lindur në Komunën e Skënderajit.

Duke marr parasysh numrin e popullsisë në vitin 2020 dhe të dhënat e diasporës në vitin 2017 del se Komuna e Skënderajit krahas numrit të popullsisë renditet në 15 komnatat me shkallë më të lartë të diasporës.

Fig. 4 Diaspora si përqindje e popullsisë




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

¹ Regjistrimi i Diasporës nga Ministria e Diasporës (tash Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës) më 2017.

Territori


Territori i komunës së Skënderajt shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshinë 378 km² apo 3% të sipërfaqes së territorit të Kosovës. Komuna e Skënderajt përbëhet nga qyteza e Skënderajt si qendër urbane dhe 51 fshatra.

Fig.5 Territori në km²



Por, Skënderaji rënditet si komuna e 21-të për nga densiteti i popullsisë (138 banorë për kilometër katrorë).


Fig.6 Densiteti (populli për km²)



Përfaqësimi politik

Në pesë palë zgjedhjet lokale për kuvend komunal tri parti politike kanë marrë pjesë vazhdimisht (LDK, PDK, AAK). Në zgjedhjet e fundit për kuvendin komunal partia me përqindjen më të madhe të votave është PDK (62%). Ndërsa, pas saj renditen, AKR (10%), Iniciativa Qytetare 'Dyzetenjëmijë' (6%).

Fig. 7 Zgjedhjet për Kuvend Komunal (2000–2017)



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e KQZ

Nga viti 2000 deri në vitin 2021 në komunën e Skënderajt postin e kryetarit e kanë ushtruar tre persona.


Tab. 1 Kryetarët e Komunës së Skënderajt nga viti 2000.

Vitet	Kryetari/ja
2000 – 2002	Ramadan Gashi (PDK)
2002 – 2007	Ramadan Gashi (PDK)
2007 – 2009	Sami Lushtaku (PDK)
2009 – 2013	Sami Lushtaku (PDK)
2013 – 2017	Sami Lushtaku (PDK)
2017 – 2021	Bekim Jashari (I pavarur)

Buxheti

Buxheti i planifikuar i Komunës së Skënderajt për vitin 2021 është 14,2 milionë euro apo 743 mijë më pak se në vitin 2020.


Fig. 8 Buxheti vjetor 2013–2021 (në euro)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve


Në karahasim me komunat tjera, për nga buxheti Komuna e Skënderajt radhitet e 15-ta.

Fig. 9 Planifikimi i buxhetit sipas komunave 2021 (në euro)



Në bazë të kategorisë së të hyrave, në vitin e fundit është vërejtur ulje e transfereve qeveritare nga niveli qendror dhe rënie e të hyrave vetanake (të planifikuara).


Fig. 10 Planifikimi i të hyrave (në euro)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Të hyrat kryesore komunale për Komunën e Skënderajt janë tatimi në pronë dhe taksat e tjera komunale, të cilat krahas nënkategorive të tjera të të hyrave në vitin 2021 kanë pësuar edhe rritjen më të madhe. Të hyrat e tjera komunale më me peshë janë taksat e pajisjeve motorike, çertifikatat dhe dokumentet zyrtare e kështu me radhë.


Fig. 11 Të hyrat vetanake



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit të Komunës së Skënderajt shpenzohet për paga dhe mëditje (57%).


Fig. 12 Buxheti i planifikuar i komunës së Skënderajt sipas kategorive ekonomike (2021)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Skënderajt radhitet e 18-ta prej komunave që shpenzojnë më shumë për paga dhe mëditje.


Fig. 13 Shpenzimet e planifikuara për paga dhe mëditje (2021)



Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Sa i përket kategorisë së shpenzimeve kapitale, 20% e buxhetit ndahet për investime kapitale.

Fig. 14 Shpenzimet Kapitale (të realizuara)




Burimi: GAP, bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve

Mirëqenia Sociale dhe Shëndetësia

Skema e ndihmës sociale


Në mars të vitit 2021 ishin 922 familje nga Skënderaj në skemën e ndihmës sociale me gjithsej 4,104 anëtarë. Nëse e krahasojmë me të dhënat e vlerësimit të popullsisë në fund të vitit 2019 del se 8% e banorëve të Skënderajt janë në skemën e ndihmës sociale.

Fig. 15 Popullsi në skemën e ndihmës sociale (mars 2021) kundrejt numrit total të popullsisë (vlerësimi 2019)



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për mirëqenien sociale dhe vlerësimin e popullsisë për 2019

Fig. 16 Përfituesit e ndihmave sociale në Skënderaj (2016–2021) sipas anëtarëve të familjes




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për mirëqenien sociale

Shëndetësia

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skënderaj janë të angazhuar gjithsej 178 punëtorë shëndetësorë, prej tyre 30 mjekë, 105 infermierë, tre stomatolog/e, një farmacist/e dhe 39 bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe jo medicinal.

Sa i përket relacionit mes kuadrit shëndetësor dhe popullsisë, Komuna e Skënderajt është në mesin e atyre komunave ku relacioni është mesatarisht i ulët.


Fig. 17 Kuader shëndetësor për popullsi



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për vlerësimin e popullsisë dhe të dhënat e MFT për numrin e të punësuarve sipas organizatave buxhetore

Në Komunën e Skënderajt, mësimin e ndjekin 9,775 nxënës në të gjitha nivelet e arsimit para univesitarë. Numri i nxënësve në shkollat e Skënderajt në vazhdimsi ka rënë, ku në vitin shkollor 2018/2019 ka 34% më pak nxënës se sa në vitin shkollor 2008/2009.


Fig. 18 Numri i nxënësve nga viti shkollor 2008/09 deri 2019/20



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Në krahasim me komunat tjera, rënie e nxënësve në Komunën e Skënderajt është mesatarisht e lartë.


Fig. 19 Trendi i numrit të nxënësve 2008/09-2019-20



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Sa i përket pesonelit nëpër shkolla, Komuna e Skënderajt ka të punësuar 664 mësimdhënës, 129 pesona ndihmës dhe 66 administrativ.


Fig. 20 Mësimdhënës, personel ndihmës dhe administrativ në shkollat e Skënderajt



Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët Komuna e Skënderajt ka një ndër shkallët më të larta sa i përket relacionit nxënës-mësimdhënës, apo një mësimdhënës për 15 nxënës.

Fig. 21 Raporti mësimdhënës-nxënës në nivelin parafillor, fillor dhe mesëm i ulët




Burimi: GAP, bazuar në statistikat e arsimit të MASH

Administrata komunale

Në administratën komunale të Skënderajt janë të punësuar 175 shërbyes civil, apo një shërbyes për 299 banorë. Komuna e Skënderajt rënditet e 14-ta ku relacioni shërbyes civil-popullatë është më i lartë në krahasim me komunat tjera.


Fig. 22 Shërbyes civil për popullatë



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK për vlerësimin e popullsisë dhe të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarëve në shërbimin civil në Skënderaj, 44 janë gra apo 25% e shërbyesve civil. Skënderaj bën pjesë në mesin e komunave me pjesëmarrje më të ulët të grave në shërbimin civil komunal.


Fig. 23 Përqindja e grave në shërbimin civil



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Nga 24 pozita udhëheqëse në shërbimin civil komunal të Skënderajt, gratë udhëheqin me tri pozita apo 13% të pozitave udhëheqëse.


Fig. 24 Përqindja e grave në pozita udhëheqëse në shërbimin civil



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Mosha mesatare në shërbimin civil të Komunës së Skënderajt është 49 vjeç.

Fig. 25 Mosha mesatare në shërbimin civil




Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e MPB për numrin e shërbyesve civil sipas organizatave buxhetore

Transparenca buxhetore

Në vlerësimin më të fundit të Institutit GAP për transparencën buxhetore të komunave për vitin 2018, Komuna e Skënderajt radhitet e 15-ta dhe është vlerësuar me 64.5 pikë nga 100 të mundshmet.

Fig. 26 Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2018



Burimi: GAP, Indeksi i Transparencës Buxhetore 2018

— Transparenca komunale

Në indeksin e vlerësimit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI)² për transparencën në komuna për vitin 2020, Komuna e Skënderajt radhitet në vendin e 13 nga 38 komuna.

Në gjashtë shtyllat e vlerësimit të KDI, Komuna e Skënderajt ka marr këtë vlerësim:

Tab. 2 Transparenca Komunale (2020)

	Pikët maksimale	Skënderajt	Rangimi në krahasim me komunat tjera
I	30	20.4	19
Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike)			
II	25	18.75	13
Transparenca buxhetore			
III	10	10	1
Qasja në dokumente publike			
IV	15	15	1
Informimi dhe pjesëmarrja e publikut			
V	10	7.5	3
Grantet dhe financimi			
VI	10	8.75	10
Etika profesionale dhe konflikti i interesit			

² KDI. Indeksi i Transparencës për qeverisjen komunale 2020. Prill 2021. Burimi: <https://bit.ly/3cLC8mz>

Konkurueshmëria e komunave

Për çdo vit, Instituti Riinvest vlerëson komunat sa i përket konkurrueshmërisë dhe shkallën në të cilën ato arrijnë të krijojnë një mjedis afarist të favorshëm. Indeksi bëhet duke vlerësuar barrierat e hyrjes në treg, transparencën e informatave publike, pjesëmarrja dhe konsultimi i biznesve në vendimmarrje, kostot kohore, taksat dhe tarifatat, aftësia e administratës komunale, fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese, si dhe infrastruktura lokale.

Nga 38 komuna, skënderaj radhitet komuna e fundit, me 4.67 pikë nga 10 maksimale. Vlerësimi sipas nën-indeksëve duket kështu.³

Tab. 3 Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave 2020


	Pikët maksimale	Skënderaj	Rangimi në krahasim me komunat tjera
Barrierat e hyrjes në biznes	10	5.57	32
Transparenca	10	6.22	15
Pjesëmarrja dhe parashikueshmëria	10	5.73	14
Kostoja kohore	10	1.38	8
Taksat dhe tarifatat	10	6.08	20
Aftësia e administratës lokale	10	2.37	37
Fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse për biznese	10	3.2	37
Infrastruktura lokale	10	6.81	9

³ Riinvest. Indeksi i konkurrueshmërisë së komunave 2020. Burimi: <https://bit.ly/3x6jg2N>

Ekonomia lokale

Në korrik të vitit 2021 në Komunën e Skënderajt ishin 1,431 biznese aktive. Përkundër pandemisë, numri i bizneseve në këtë komunë ka shkuar duke u rritur. Në sektorin privat në Komunën e Skënderajt janë të punësuar 2,541 persona.


Fig. 27 Bizneset aktive në komunën e Skënderajt dhe numri të punësuarve



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ATK të siguruar sipas kërkesës për qasje në informata zyrtare

Në dhjetë vitet e fundit numri i bizneseve të reja është çdoherë më i madh se numri i bizneseve të shuara.


Fig. 28 Numri i bizneseve të reja dhe të shuara



Burimi: GAP, bazuar në të dhënat e ASK


Përveç, 2,541 të punësuarve në sektorin privat në territorin e Komunës së Skënderajt, në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar edhe 1,300 persona.

Fig. 29 Numri i të punësuarve në sektorin publik dhe privat në komunën Skënderaj



Në anën tjetër, numri i kontributpaguesve aktiv nga Skënderaj në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust) është shumë më i madh. Kjo tregon se pjesa më e madhe e të punësuarve nga Komuna e Skënderajt janë të punësuar në biznese apo institucione publike jashtë territorit të komunës.

Fig. 30 Kontribues në trust



Shërbimet publike


— Qasja ne ujësjellës

Sipas raportit të MAPL për performancën e komunave, Komuna e Skënderajt në 80.38% të sipërfaqës së komunës ka qasje në rrjet të ujësjellësit.

Nga 52 lokalitete në Komunën e Skënderajt, Kompania Rajonale e Ujësjellësit "KRU Mitrovica" menaxhon ujësjellësin në 49 vendbanime me gjithsej 61 mijë banorë. "KRU Mitrovica" menaxhon ujësjellësin në qytetin e Skënderajt dhe në fshatrat: Abri e Poshtme, Aqarevë, Bajë, Baks, Burojë, Cirez, Citak, Cubrel, Dashec, Izbicë, Klinë e Epërme, Klinë e Poshtme, Klinë e Mesme, Klladernice, Kopiliq i Epërm, Kopiliq i Poshtëm, Kostërc, Kotorr, Kozhicë, Krasaliq, Krasmiroc, Kryshec, Kucicë, Lecinë, Likoc, Lubavec, Llaushë, Makërmal, Marinë, Mikushnicë, Murgë, Pemishtë, Plluzhinë, Polac, Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Prelloc, Radishevë, Rakinicë, Rezallë, Runik, Syriganë, Tërnavc, Ticë, Turiçec, Tushilë, Vajnik dhe Vitak . Ndërsa në fshatrat: Jashanicë, Tushilë, dhe Ozdrim mungon shërbimi i ujit nga KRU Mitrovica.


Në krahasim me komunat e tjera Skënderaji rënditet e 21-ta për qasje në rrjetin e ujësjellësit nëpër vendëbanime.

Fig. 31 Përqindja e qasjes së vendbanimeve në rrjetin e ujësjellësit (2019)



Në krahasim me komunitat tjera, Komuna e Skënderajt është një ndër komunitat me shtrirje mesatare të rrjetit të kanalizimit.


Fig. 32 Përqindja e qasjes së vendbanimeve në rrjetin e kanalizimit



Menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Skënderajt në raport me komunat e tjera rënditet e 26-ta për nga rrjeti i menaxhimit të mbeturinave.

Fig. 33 Përqindja e vendbanimeve të cilat mbulohej nga kompanitë për menaxhim të mbeturinave



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP përkrahet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt mbështetet nga:



